



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

V E N D I M

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 29 DATË 05.07.2019, TË PARTISË BINDJA
DEMOKRATIKE ME OBJEKT "PËR SHPALLJEN E PAVLEFSHME TË ZGJEDHJEVE NË
BASHKINË DURRËS".**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 10.07.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: **Partia Bindja Demokratike**, e përfaqësuar nga z. Fabian Topollari.

PALË TË INTERESUARA: **Partia Socialiste e Shqipërisë**, e përfaqësuar nga z. Eridjan Salianji.

OBJEKT: Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 29 datë 05.07.2019, të partisë Bindja Demokratike me objekt "Për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në Bashkinë Durrës".

BAZË LIGJORE: Neni 7, neni 23, pika 1, germa "a", neni 21, pika 7, neni 143, neni 160, neni 161 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike.

VËREN

Partia Bindja Demokratike ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesë ankimore, me objekt "Për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në Bashkinë Durrës" e cila në



respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në Regjistrin e Ankimeve Zgjedhore, me Nr. 29 regj, datë 05.07.2019.

Rezulton se Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me vendimin nr. 945, datë 05.07.2019 "Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Durrës, Qarku Durrës, në zgjedhjet vendore të datës 30 Qershor 2019" ka shpallur rezultatin e zgjedhjeve për Këshillin e Bashkisë Durrës.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përputhje me nenet 134 e vijues të Kodit Zgjedhor, në seancën plenare të datës 10.07.2019, ora 11:00, zhvilloi shqyrtimin administrativ të kërkesës ankimore nr. 29 datë 05.07.2019 të depozituar nga Partia Bindja Demokratike.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi verifikoi pjesëmarrjen e ankuesit, mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga Partia Socialiste e Shqipërisë, për të marrë pjesë në shqyrtimin e ankimit administrativ të kërkesës ankimore nr. 29 si palë e interesuar dhe pasi i çmoi këto kërkesa në përputhje me nenin 133, pika 1, 2 dhe 3, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar vendosi pranimin e Partisë Socialiste si palë të interesuar në këtë proces.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përfundim të verifikimit të legjitimitetit procedural të palëve ftoi ankuesin e më pas palën e interesuar, të paraqesin pretendimet dhe prapësimet e tyre.

Ankuesi, Partia Bindja Demokratike, në pretendimet e tij sikurse parashtron në kërkesën ankimore nr. 29 parashtron se:

- Në Zgjedhjet Vendore të 30 qershorit Partia Bindja Demokratike ka konkuruar në këtë Zonë Zgjedhore me lista shumëemërore për kandidatë për Këshillat Bashkiakë. Partia Bindja Demokratike, gjatë procesit të votimit, ditën e zgjedhjeve, ka pasur vëzhguesit dhe nga raportimet e tyre në të gjitha QV-të e saj rezultojnë mospërputhje të larta të numrit të votuesve, që janë paraqitur për të votuar atë ditë, me numrin e fletëve të votimit të gjendura në kuti.

- Gjatë procesit të votimit zgjedhësve të ndryshëm u është dhënë më shumë se një fletë votimi për të votuar dhe këta zgjedhës vetë ose anëtarë të Komisionit të Qendrës së Votimit kanë firmosur fiktivisht në listën e zgjedhësve, me qëllim rritjen fiktive të pjesëmarrjes në zgjedhje dhe manipulimin e rezultatit të zgjedhjeve në favor të Partisë Socialiste dhe aleatëve të saj, të cilët kishin të gjithë anëtarët e komisioneve të Qendrave të Votimit në këtë zonë zgjedhore.

- Me përfundimin e procesit të votimit vëzhguesve tanë u është kërkuar të dalin jashtë qendrës së votimit, me qëllim që gjatë procesit të mbylljes së kutive dhe hartimit të procesverbaleve përkatëse prezent atje të ishin vetëm komisionerët e QV, të gjithë përfaqësues të Partisë Socialiste. Në mungesë të vëzhguesve tanë, ne kemi indicie të forta, që vijnë nga numërimi i votuesve gjatë ditës së votimit, se Komisionerët e QV-ve kanë shtuar vota në kutitë e votimit dhe kanë firmosur në listën e zgjedhësve, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes dhe ndryshimit të rezultatit të zgjedhjeve në atë QV.

- Procesi i numërimit dhe vlerësimit të votave nga Grupet e Numërimit është bërë në shkelje të ligjit, vëzhguesit e BD kanë konstatuar se pothuaj në çdo kuti të numëruar prej grupeve të numërimit, ka një mospërputhshmëri të lartë midis votave reale të marra nga kandidatët tanë, në



krahasim me rezultatin e shënuar në tabelat e numërimit të votave për këto qendra votimi nga ana e numëruesve.

Procesi i votimit dhe numërimit të votave është administruar vetëm nga një parti politike, Partia Socialiste edhe kur ndonjëri prej tyre është shënuar si i propozuar nga shoqëria civile.

- Nga raportimet e vëzhguesve tanë konstatojmë se numri i shtuar i fleteve të votimit në QV-të e kësaj Zone Zgjedhore është pothuaj në çdo rast, jo vetëm me ndikim në ndarjen e mandateve nga lista shumëemërore për këshillat bashkiakë, por edhe më e madhe se diferenca midis kandidatëve garues për Kryetar Bashkie.

Për të vërtetuar pretendimet se ka pasur një shtim fiktiv të numërit të votave gjatë procesit të votimit ankuesi referuar nenit 136 pika 1, germa "c" kërkon si provë hapjen e të gjithë kutive të materialeve zgjedhore, për të bërë një verifikim midis numrit të votave dhe zgjedhësve që kanë nënshkruar në listën e zgjedhësve të cilët kanë votuar në 30 qershor.

Verifikim midis zgjedhësve që rezultojnë të kenë votuar në 30 qershor me sistemin TIMPS për të vërtetuar se shumë qytetarë të cilët nuk kanë qenë fare prezent në teritorin e Republikës së Shqipërisë atë ditë rezultojnë votues në datën 30 qershor në Bashkinë Durrës.

Neni 136 i Kodit Zgjedhor përcakton detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që ta marri këtë provë për sa kohë që ne nuk kemi pasur mundësi që ta siguronim paraprakisht këtë provë për shkak se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka lejuar Partinë Bindja Demokratike që të ketë përfaqësuesit e saj në Komisionet e Qendrave të Votimi dhe në Grupet e Numërimit. Ky pretendim faktohet me shkresën e protokolluar nga Bindja Demokratike që në 14 qershor të 2019 pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me numër protokollit 11530 ku në bazë të përcaktimeve të Kodit Zgjedhorë Bindja Demokratike ka kërkuar pasjen e komisionerëve dhe numëruesve të saj në të gjithë qendrat e votimit dhe në të gjitha grupet e numërimit. Kjo kërkesë e Bindjes Demokratike nuk është shqyrtuar nga KQZ-ja në atë kohë, kështu që nuk kemi pasur asnjë mundësi që pretendimet tona të mund t'i provojmë nëpërmjet provave shkresore që në këtë rast i kanë vetëm anëtarët e komisioneve të qendrave të votimit dhe të grupeve të numërimit.

- Pala e interesuar, Partia Socialiste e Shqipërisë, përfaqësuar z. Eridian Saliqji, parashtroi në pretendimet e tij se nga parashtrimet e ankuesit ankimi është bërë në bazë të vëzhgimit që kanë bërë vëzhguesit e Bindjes Demokratike të të gjithë procesit zgjedhor dhe fjalës që ata kanë sjellë në Tiranë. Ankuesi nuk kërkon pavlefshmëri në qendra të caktuara votimi por thotë pavlefshmëria e të gjithave Qendrave të Votimit dhe më pas të gjithë Bashkisë.

Kodi Zgjedhor në dispozitën e tij për pavleshmërinë e zgjedhjeve kërkon specifikisht pavlefshmërinë në qendrën të caktuara të votimit. Subjekti ankues duhet të evidentojë disa Qendra Votimi konkrete ku pretendon se ka ndodhur parregullsia dhe të kishte sjellë në këtë shqyrtim, shkaqe dhe prova konkrete për çdo qendër votimi të pretenduar se ka shkelje.

Referuar nenit 7 të ligjit të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar parashikohen detyrat e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore dhe rezultoni se vëzhguesit dhe anëtarët kanë pothuajse detyra të njëjta, përveç faktit se vëzhguesit e subjekteve zgjedhore nuk kanë të drejtë vote. Ankuesi duhet të depozitojë prova të mjaftueshme të cilat të shërbejnë si indicie për të thelluar hetimin me këqyrjen e materialeve zgjedhore në kutinë e materialeve zgjedhore dhe me pas me këqyrjen e fletëve të votimit.



Pala e interesuar deklaroi që kërkesa ankimore e paraqitur nga Partia Bindja Demokratike është e pabazuar në prova dhe në ligj.

Pas paraqitjes së pretendimeve të palëve, për nevoja të hetimit administrativ, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi të administrojë si prova Librin e Protokollit të Mbledhjeve, Proces-Verbalet e Konstatimit, të KZAZ-ve nr. 21, 22, 23, 24 tabelën përmbledhëse të rezultateve dhe tabelat e rezultatit të qendrave të votimit për zonën zgjedhore Bashkia Durrës.

Në analizë të provave, pretendimeve dhe kërkesave të palëve në proces Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vlerëson se:

Referuar nenit 7 të kodit Zgjedhor vëzhguesit kanë të drejtë të paraqesin vërejtje me shkrim para komisioneve të zgjedhjeve për çdo lloj parregullsie që vërejnë.

Po sipas procedurave të përcaktuara në nenin 116, pika 6 dhe 118 të Kodit Zgjedhor këto kontestime duhet të pasqyrohen në dokumentacionin zgjedhor si kundër është Procesverbali i Konstatimit dhe Libri i Protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së.

Nga hetimi i dokumentacionit zgjedhor nga vëzhguesit e palës ankuese nuk është administruar asnjë vërejtje me shkrim gjatë procesit të numërimit të votave. Në këtë dokumentacion nuk ka asnjë shënim e cila të shërbejë si indicie për thellim të hetimit administrativ, me rinumërimin dhe rivlerësimin e votave.

Subjekti ankues kërkon realisht pavlefshmërinë e zgjedhjeve në Bashkinë Durrës dhe e mbështet ankimin në bazën ligjore përveçse neneve 124, 125, 126 në nenin 160 dhe nenin 161 që lidhen posaçërisht me pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Neni 160, pika 1, pika konkretisht parashikon pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qendrën e votimit. Konkretisht neni 160 parashikon KQZ-ja kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore i shpall zgjedhjet të pavlefshme në një apo më shumë qendra votimi në rast se:

- a) Ka ndodhur shkelje të ligjit të cilat kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor ose kur tërësia e shkeljeve të ligjit sipas kësaj shkronje të ndodhura në ato qendra votimi mund të ketë cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore.
- b) Ka ndodhur fatkeqësi natyrore në përmasat të tilla që kanë penguar pjesmarrjen e zgjedhësve në votim ose :
- c) Votimi nuk ka filluar apo është pezulluar për më shumë se 5 orë.

Subjektet zgjedhore, në përputhje me rregullat dhe afatin e përcaktuar në nenin 124 të Kodit Zgjedhor kanë të drejtë të kërkojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në qendra votimi të caktuara. Kërkesa për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve duhet të përmbajë shkaqet ligjore, përshkrimin e rasteve të shkeljeve dhe arsyetimin e detajuar për pasojën e tyre, Këto detyrime ligjore nuk rezultojnë në ankimin e paraqitur nga ankuesi.

Referuar nenit 161, pika 1 dhe 2 të Kodit Zgjedhor, pas përfundimit të procesit të ankimit jo më vonë se 3 ditë nga nxjerrja e rezultatit të zonës zgjedhore Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kryesisht ose me kërkesë të subjektit shpall të pavlefshme dhe urdhëron përsëritjen e zgjedhjeve



në të gjithë zonën zgjedhore kur pavlefshmëria e shpallur në një ose disa qendra votimi sipas nenit 160 ndikon në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore ose në shkallë vendi.

Do të konsiderohet ndikim në ndarjen e mandateve për zgjedhjet në Kuvend kur numri i zgjedhësve që kanë votuar apo mund të kishin votuar në qendrën apo qendrat e votimit të shpallura të pavlefshme është i barabartë ose më i madh se numri i zgjedhësve të nevojshëm për caktimin e një mandati në zonën zgjedhore përkatëse mbi bazën e përlogaritjes së votave të vlefshme në zonën zgjedhore të bërë sipas nenit 162 Kodit Zgjedhor. Përsëritja e zgjedhjeve urdhërohet në të njëjtin vendim të KQZ-së që i shpall ato të pavlefshme. **Zgjedhjet për këshillat e qeverisjes vendore nuk përsëriten.**

Referuar vendimit nr. 21, datë 27.07.2013, vendimit nr. 45, datë 18.11.2013, Vendimit nr. 29 datë 10.07.2015 të Kolegjit Zgjedhor dhe në analizë të dispozitave të mësipërme rezultojnë se:

Kodi Zgjedhor obligon pavlefshmërinë me rrjedhojë përsërirjen e zgjedhjeve, në ato raste kur:

1. Vërtetohen shkelje të ligjit, të cilat kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor.
2. Tërësia e shkeljeve "mund" të ketë cënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve.

Për të vlerësuar paligjshmëtrinë e veprimi të kryer, pra për të vërtetuar atë që parashikon Kodi Zgjedhor, nëse shkelja e ligjit ka qenë e tillë sa ka cënuar rëndë procesin zgjedhor, apo nëse tërësia e shkeljeve të kryera ka qenë e atyre përmasave sa mund të ketë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve, orientohemi nga konceptet që ka përpunuar jurisprudencë gjyqësore mbi parimin e proporcionalitetit.

Terminologjia "rëndë" dhe "ndikimi në një masë të tillë", i përdorur nga neni 160, paragrafi 1 shkronja "a" të Kodit Zgjedhor, imponon kryerjen e një vlerësimi të arsyeshëm, objektiv dhe të paanshëm, mbi natyrën e shkeljes së ligjit. Kolegji Zgjedhor vlerëson se kuptimi i saktë dhe i drejtë i terminologjisë së përdorur në këtë dispozitë ligjore, duhet të analizohet dhe të vlerësohet në tërësi nga disa faktorë, që kanë të bëjnë me rëndësinë e shkeljes së ligjit, pasojat e ardhura apo që mund të vinin nga kjo shkelje, kohëvazhdimin e këtyre pasojave dhe të vështirësive për riparimin e tyre, si dhe vetë qëndrimin subjektiv që mban personi konkret ndaj shkeljes së kryer dhe pasojës së ardhur (*Shih vendimi nr. 75 datë 19.04.2002 i Gjykatës Kushtetuese*).

Termi "rëndë" i përdorur në ligj, për të dalluar intesitetin e cënimit që mund t'i bëhet procesit zgjedhor, nënkupton edhe interpretimin *a contrario* se, procesi zgjedhor do të pranohet si i vlefshëm dhe ligjor nëse përderisa shkeljet e kryera nuk janë të asaj shkalle, sa të vlerësohen si të rënda. Pra, cilësimi i rëndë i shërben gjykatës për të dalluar këto veprime, nga sjelljet e një kategorie më të lehtë, të cilat nuk mund të përdoren për të cënuar gjithë procesin zgjedhor dhe për të shpallur të pavlefshme zgjedhjet. Ky është një koncept që pranohet tashmë, jo vetëm nga jurisprudencë e Gjykatës Kushtetuese apo e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por edhe nga legjislativi ynë. Këtë kuptim ka edhe neni 40, pika 4 i ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", sipas të cilit, "Gjykata vendos rrëzimin e padisë dhe kur vlerëson se, pavarësisht shkeljeve procedurale të konstatuara të veprimtarisë administrative, pasojat do të ishin të njëjta. Pikërisht këtë vlerësim bën Kolegji Zgjedhor, nisur nga parimi i proporcionalitetit, parim i cili kërkon një baraspeshim të përshtatshëm e të arsyeshëm (pa shpërfillur faktet apo rrethanat që kanë rëndësi për çështjen), midis cënimit që i bëhet një të drejte konkrete dhe interes të ligjshëm publik.



Përsëritja e zgjedhjeve nuk mund të kryhet për çdo shkelje të evidentuar qoftë kjo e lidhur dhe me parimet e zgjedhjeve përveçse kur provohet se shkeljet janë të tilla që kanë ndikuar në rezultatin final¹.

Vlen të përmendet se në nenin 161, paragrafi i pestë të Kodit Zgjedhor parashikohet se "Përsëritja e zgjedhjeve urdhërohet në të njëjtin vendim të KQZ që i shpall ato të pavlefshme. **Zgjedhjet për këshillat e qeverisjes vendore nuk përsëriten.**", parashikim ky që është bërë në Kodin Zgjedhor aktual (një parashikim i tillë nuk gjendet në Kodin Zgjedhor të shfuqizuar) dhe ligjvënësi nëpërmjet këtij përcaktimi ka përjashtuar përsëritjen e zgjedhjeve për këshillat e qeverisjes vendore ...² dhe në rastin konkret, në Bashkinë Durrës subjekti zgjedhor Bindja Demokratike ka garuar me lista shumemëore për Këshillin Bashkiak.

Pala ankuese në kërkesën e paraqitur vetë pranon shprehimisht në ankim se nuk ka asnjë provë shkresore për të mbështetur këtë ankim dhe gjithçka e mbështet në bindjen e vëzhguesve të saj. Ndërkohë është parashtruar nga ankuesi që në votimin e kryer në atë zonë zgjedhore dy janë fenomenet kryesore që kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor sipas saj, shtimi i fletëve të votimit në QV, ndryshimi i rezultatit në të gjitha QV-të, dhe, të dyja pretendimet mbështeten në bindjen e vëzhguesve, por se nuk identifikohen raste se në cilat qendra votimi cka është e rëndësishme në vlerësimin për ekzistencën e shkeljes së rëndë apo të ndikimit të këtyre shkeljeve në ndarjen e mandateve në atë zonë zgjedhore, që kërkon dhe përcaktimi i neni 160, paragrafi i parë, shkronja "a" i Kodit Zgjedhor.

Nuk rezulton që shkeljet që pretendon pala ankuese të provohen duke u ngritur në nivelin e shkeljeve të rënda apo shkeljeve me pasojë në ndarjen e mandateve në zonë zgjedhore që do të kushtëzonte pavlefshmëri me pasojë përsëritjen e zgjedhjeve për këshillin bashkiak për shkak të ndalimit të parashikuar në nenin 161 paragrafi 5 i Kodit Zgjedhor.

Edhe pse ankuesi pretendon se vëzhguesit gjatë ditës së zgjedhjeve kanë numëruar zgjedhësit që janë paraqitur në qendrat e votimit për të votuar, nuk paraqiti për asnjë qendër votimi sa ishte numri i zgjedhësve të konstatuar nga vëzhguesit për ta krahasuar më numrin e zgjedhësve në tabelat e rezultatit.

Më tej, rinumërimi dhe rivlerësimi i votave mund të kryhet në çdo rast kur ekzistojnë dyshime të genësishme për parregullsi dhe mosrespektim të të ligjit në procesin e numërimit e vlerësimit të votave, dyshime këto të bazuara, jo vetëm mbi prova, sic janë dokumentimi në dokumentacionin zgjedhor të kontestimeve për vota të caktuara nga ana e numëruesve apo vëzhguesve të subjekteve zgjedhore të caktuara, por edhe mbi cdo provë të ligjshme dhe të vlefshme, prova këto që sjellin fakte dhe të dhëna në lidhje me rregullsinë dhe ligjshmërinë e këtij procesi.³

Kodi Zgjedhor iu siguron palëve në një proces zgjedhor, cdo partie politike pjesëtare ose jo të një koalicioni zgjedhor, ashtu sikundër edhe kandidatit të mbështetur nga zgjedhësit, të drejtën e ankimit kundër vendimit të KZAZ dhe të KQZ për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të një zone zgjedhore të caktuar, në kuadër të së cilës përfshihet edhe e drejta për kërkimin e provës nëpërmjet rinumërimit dhe ose rivlerësimit të votave të caktuara, e drejtë kjo e fundit që mund të

¹ Për më gjerë shiko Vendim nr. 45, datë 18.11.2013 i Kolegjit Zgjedhor

² Për më gjerë shiko Vendim nr. 29, datë 10.07.2015 i Kolegjit Zgjedhor.

³ Për më gjerë shiko vendim nr. 21, datë 27.07.2013



realizohet nëse ato paraqesin prova të ligjshme dhe të vlefshme, që venë në dyshim rregullsinë dhe ligjshmërinë e procesit të numërimit dhe vlerësimit të këtyre votave.⁴

Indicjet që paraqet ankuesi nuk rezutojnë të mjaftueshme për cënimin e integritetit të kutive të votimit.

Është e qartë se Kodi Zgjedhor, neni 136 në lidhje me nenin 138, ngarkojnë subjektin ankues me barrën e provës në lidhje me ekzistencën e indicjeve në funksion të kërkesës për marrjen e provave, këqyrjen, rinumerimit dhe/ose rivlerësimin e votave të caktuara, cka do të thotë se provat, njoftimet për fakte dhe rrethana konkrete, në lidhje me vërtetimin e këtyre indicieve, i paraprijnë këtij procesi (këqyrjes, rinumërimit dhe/ose rivlerësimit të votave të caktuara) dhe nuk mund të përftohen prej tij.

Edhe në ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", sipas parashikimeve të nenit 82 barra e provës i takon palës palës që inicion procedurën.

Neni 82

Barra e provës

1. Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.

2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.

3. Në mënyrë që të mbështesin pretendimet e tyre, palët mund t'i bashkëlidhin kërkesës për fillimin e procedurës administrative dokumente ose fakte të ndryshme. 4. Palët mund t'i kërkojnë organit publik që të marrë masat e nevojshme për të siguruar përdorimin e provave të zotëruara prej tij gjatë procedurës administrative.

Edhe në parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, Barra e provës (*onus probandi*) është përcaktimi i palës në proces, e cila duhet të provojë faktin e pretenduar me mjetet provuese.

Në nenin 12 të Kodit të Procedurës Civile jepet një përkufizim i ngjashëm me këtë: "Pala që pretendon një të drejtë, ka detyrimin që në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilat bazon pretendimin e saj". Është detyrë e palëve në proces për të paraqitur pretendimet lidhur me faktet në të cilat i mbështesin kërkimet e tyre, si dhe provat me të cilat mund të vërtetohen këto pretendime. Ky rregull zbatohet si për kërkesë padinë e paditësit ashtu edhe për prapësimet e të paditurit. Pikërisht këto detyrime të palëve në teori janë quajtur barra e provës. Në procesin gjyqësor civil rregullat për ndarjen barrës së provës e zgjidhin çështjen se cila palë do të humbas gjyqin kur një fakt mbetet i pa provuar. Rregulli i përgjithshëm se secila palë e ka barrën e provës për ato fakte të cilat i vijnë asaj në ndihmë. Kjo do të thotë se pala që pretendon ekzistencën e një të drejte, e ka barrën e provës së atyre fakteve që parashikon e drejta materiale si prezumim i ekzistencës së saj dhe e kundërta, pala që mohon ekzistencën e një të drejte ka barrën e provës së fakteve që pengojnë e saj ose se ajo është shuar.

Pavarësisht këtyre parashikimeve dhe detyrimeve ligjore, subjekti zgjedhor ankues, sikurse thekson edhe vetë në ankim, nuk është në gjendje të paraqesë asnjë provë shkresore përpara Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të tillë që të justifikojë ligjërisht kërkesën për pavlefshmërinë e zgjedhjeve.

⁴ Për më gjerë shiko vendim nr. 21, datë 27.07.2013



Për sa i përket pretendimit se Partia Bindja Demokratike ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kërkesë për të patur komisionerë dhe numërues të saj në të gjithë qendrat e votimit dhe në të gjitha grupet e numërimit apo për të patur vëzhgues, pranë këtyre komisioneve, KQZ vlerëson se:

Përbërja e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor dhe ngritja e tyre, bëhet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve 90 ditë para datës së zgjedhjeve, që korespondon me datën 30 mars 2019, sipas përcaktimeve të nenit 28 dhe 29 të Kodit Zgjedhor. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 18, datë 01.02.2019 "Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët e KZAZ-ve, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019" ka përcaktuar partitë të cilat kanë të drejtë të propozojnë anëtarë në Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor.

Referuar nenit 36, pika 1 të Kodit Zgjedhor KQV-ja formohet sipas mënyrës dhe kritereve të përcaktuara në nenin 29 të Kodit Zgjedhor për KZAZ-të. Partia Bindja Demokratike referuar vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është krijuar më datë 25.05.2019. Në kohën kur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka përcaktuar partitë të cilat kanë të drejtë të propozojnë anëtarë në Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor, Partia Bindja Demokratike nuk ishte krijuar ende si parti politike.

Për sa i përket përbërjes së KQV-ve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimet nr. 141, datë 09.04.2019, nr. 802, datë 10.06.2019, nr. 831, datë 12.06.2019, nr. 864, datë 25.06.2019, etj "Për miratimin e listave emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019", ka miratuar rast pas rasti listën e personave që mund të emërohen kryesisht nga KZAZ-të anëtarë në KQV. Partia Bindja Demokratike në rast se konstatonte se vendimet e sipërcituara të KQZ-së, çënonin interesat e ligjshme për anëtar në KQV mund të bëntë ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Kundër vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Partia Bindja Demokratike nuk ka paraqitur në asnjë rast ankim në Kolegjin Zgjedhor.

Për sa i përket kërkesës për regjistrimin e vëzhguesve, referuar pikës 1 dhe 6 nenit 6, të Kodit Zgjedhor, si dhe udhëzimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 10, datë 14.04.2009, vëzhguesit e partive politike dhe koalicioneve rregjistrohen pranë KZAZ-ve. Referuar ankimit të paraqitur dhe deklarimeve të ankuesit gjatë shqyrtimit administrativë, rezulton së kërkesa e Partisë Bindja Demokratike për regjistrimin e vëzhguesve është pranuar nga KZAZ-të ku është paraqitur kërkesa dhe vëzhguesit e saj kanë qenë të pranishëm në Qendrat e Votimit dhe për cdo tavolinë numërimi në vendet e numërimit të votave.

Pavarësisht faktit se pala ankuese nuk paraqiti asnjë provë dhe as arriti të argumentojë indicie të mjaftueshme për pretendimet e saj, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe të Kodit të Procedurave Administrative administroi provat dhe nga këqyrja e dokumentacionit të administruar si provë nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rezulton se:

- Numri i votuesve në KZAZ-të nr. 21, 22, 23, 24 është 40 724.
- Numri i fletëve të votimit të gjetura në kuti për KZAZ- të nr. 21, 22, 23, 24 është 40 775.
- Në proces-verbalet e konstatimit të KZAZ-të nr. 21, 22, 23, 24 nuk është pasqyruar asnjë parregullsi gjatë procesit të voimit.



- Në Librin e Protokollit të Mbledhjes të KZAZ-të nr. 21, 22, 23, 24 janë regjistruar veprime normale të funksionimit të KZAZ-të dhe nuk është regjistruar asnjë parregullsi apo problematikë.

Nga hetimi rezultoi se në dokumentacionin zgjedhor të administruar në cilësinë e provës për sa i përket pretendimit të palëve ankuese, nuk gjendeshin prova dhe indicie të mjaftueshme që KQZ të hetonte më tej. Gjithashtu nga krahasimi i të dhënave në dokumentacionin zgjedhor në lidhje me numrin e zgjedhësve që kanë votuar dhe fletë të votimit gjetura në kuti, diferenca është 51. Referuar faktit se diferenca ndërmjet numrit të votave të Partisë Bindja Demokratike me subjektet e tjera garuese është në masë të tillë ku rezulton se nuk ka asnjë shkelje të ligjit e cila të ketë ndikim në ndarjen e mandateve.

Nga analiza ligjore e provave të administruara gjatë shqyrtimit administrativ, pretendimeve dhe prapësimeve të palëve në këtë proces, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve konstaton se kërkesa ankimore e paraqitur nga Partia Bindja Demokratike, është e pabazuar në prova dhe në ligj.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 21, pika 1 dhe 17, nenin 143, pika 1 germa "b", nenin 160 dhe nenin 161 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 29, të paraqitur nga partia Bindja Demokratike.
2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 945, datë 05.07.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për nxjerrjen e rezultatit të votimit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Durrës të KZAZ-ve nr. 21, 22, 23, 24".
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Tiranë, brenda 5 ditëve
5. nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

